



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimi - Pranimi M. Datë 31-03-2026			
Nr. Llogarit Org. Bë.	Nomenklatura	Shifra e Primit	Vlera Vendos
07	035	02	384



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.03.2026 miraton këtë:

DEKLARATË MBËSHTETËSE

1. Kuvendi i Komunës së Vitisë shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 19 nëntor 2024, dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të legjislaturës së VIII.
2. Kuvendi i Komunës së Vitisë mbështet gjithashtu komunikatën mbështetëse të datës 14 korrik 2025, të nënshkruar nga anëtarët e kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga misioni i OSBE-së, të mbajtur në Gjilan.
3. Me këtë deklaratë, Kuvendi i Komunës së Vitisë angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
4. Kuvendi i Komunës së Vitisë obligon strukturat përkatëse komunale, përfshirë kryesuesin e Kuvendit Komunal, kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjinore, që të promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.
5. Kjo deklaratë hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Shërbimit të Kuvendit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

